


KQZ  
U/PROTOKOLLUA  
NR/042/PROT  
DATE: 06 7 2018

**AUDITUESE LIGJORE E LEDA DHIMA**

**AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE  
PER VITIN 2017**

**PER PARTINE BASHKIMI DEMOKRAT SHQIPTAR**



Qershor 2018

## **MBI KONTROLLIN LIGJOR TE LLOGARIVE**

**Drejtuar : Komisionit Qendror te Zgjedhjeve**

**Tirane**

**Partisë Bashkimi Demokrat Shqiptar**

**Tirane**

*Te Nderuar Zoterinj:*

### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme

Sipas opinionit tonë:

**Pasqyrat financiare bashkëlidhur japin pamjen e vertete dhe te drejtë për të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar me datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.**

### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në shoqëri tuaj dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## **Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

**AUDITUES LIGJOR**

**Eleda Dhima**



*Tirane me 25.06.2018*

Lagjja "Xhevdet Nepravishata" Lushnje

Cel: 069 40 98 121

E-mail: elodadh@yahoo.it

## **SIENIME PLOTESUESE**

*Ne lidhje me auditimin e fondeve te perfituara e te shpenzuara gjate vitit kalendarik 2017 nga Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar*

### **INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.8580, dt.17.02.2001 "Për partitë politike", i ndryshuar.
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë".
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare"
- Vendimi Nr.23 date 27.04.2018 i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
- Çdo dokument ligjor të marrë prane Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar

#### **Të dhëna të përgjithshme**

"Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar" e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, me vendimin Nr.3 date 03.04.1992 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane,sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2001 "Per Partitë Politike", të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimpruese ", të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 "Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese", nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi. Subjekti zgjedhor Bashkimi Demokrat Shqiptar është regjistruar si person i tatueshem me NIPT K72006001N me adrese: rruga "Mine Peza",Ish Komiteti i Shkences dhe Teknikes Tirane. Kryetar i Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar është zgjedhur z.Ylber Valteri cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar.

#### **Mënyra e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" ne baze te parimit te arketim pageses.

pasqyruara mbi bazen e vices se faturave origjinale te teshuara nga klientet apo te dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve. Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.

Të ardhurat janë regjistruar sipas realizimit të tyre nga KQZ per fondin e zgjedhjeve te vitit 2015 ne 2 transferta ne banke ne datat 23.03.2017 dhe 08.06.2017 qe ne total arrijne 121 166.44 leke.Perdorimi i tyre është sipas planit të miratuar nga organet drejtuese te partise.

### Organizimi i Kontabilitetit

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare" sipas parimit te arketim pagesave. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me planin unik kontabël. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale. Per vitin 2017 Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar ka realizuar të ardhura dhe shpenzime si me poshte vijon.

### PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

#### Te ardhurat

Nr	Burimet e perfitimit te fondve gjate vitit 2016	Vendi i depozitimit	Lloji i monedhes			Kursi	Total ne lëke
			Leke	Usd	Ne natyre		
I	K.Q.Z.	banke	121 166.44				121 166.44
II	Burimet e veta						
III	Sponsorizimet						
	Sponsorizime						
	Sponsorizime						
IV	Te ardhura nga anetaret						
V	Interesa bankare						
VI	Te tjera						
	<b>Totali</b>		<b>121 166.44</b>				<b>121 166.44</b>

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**PARTIA BASHKIMI DEMOKRAT SHQIPTAR**

**DEKLARATE**

Pasi u njohem me vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr. 23 date 27.04.2018, per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe Shpenzuara nga Subjektet Zgjedhore per vitin 2017.

**DEKLAROJ**

Une kryetari i Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar ne zbatim te dispozites ligjore te Ligjit 10019 date 29/12/2008 i ndryshuar "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", Ligjit nr 8580 date 17.02.2000 "Per Partite Politike" i ndryshuar deklaroj se nuk kam marre kontribute sponsorizimi, dhurimi e te tjera siç parashikohet nga Ligji i mesiperm.

Kryetari i Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar deklarom se ka keto te ardhura dhe shpenzime per vitin 2017 si me poshte :

**Te Ardhurat**

Nr	Burimet e perfitimit te fondeve gjate vitit 2017	Vendi i depoziti mit	Lloji i monedhes			Kur si	Total ne leke
			Leke	Us d	Ne natyre		
I	Buxheti i shtetit	Banke	112 166.44				121 166.44
II	Burimet e veta						
III	Sponsorizimet						
	Sponsorizime						
IV	Teardhura nga anetaret						
V	Interesa bankare						
VI	Te tjera						
	<b>Totali</b>		<b>121 166.44</b>				<b>121 166.44</b>

## Shpenzimet

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Totali i shpenzimeve
1	Paga			0
2	Sigurime shoqerore			0
3	Marrje salla me qera			0
4	Reklam televizive			0
5	Blerje mjete kompjuterike			0
6	Sherbime telefonike			0
7	Shpenzime gjyqesore		arke	57 400.00
8	Shpenzime karburant		arke	43 400.00
9	Komisine		banke	2 592.06
10	Te tjera goma+riparim		arke	19 500.00
	<b>Totali</b>			<b>122 892 .06</b>

Gjendja e mjeteve te tepruara nga viti 2017 eshte ne shumen - 1725.62 lcke e cila eshte e njejte me gjendjen e llogarise bankare 0011272923 te Raffcoisen Bank..

Kete Deklarate ja paraqesim Auditueses Eleda Dhima, e cila eshte caktuar te kryej auditimin e fondeve te perftuara dhe shpenzuara nga Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar per aktivitetin e subjektit per vitin 2017.

**Kryetari i Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar**

Tirane 11.06.2018



Ylber Valteri

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR  
Eleda Dhima AUDITUESE LIGJORE  
Liçenca profesionale  
Nr.197, date 30.01.2009

LETER ANGAZHIMI AUDITIMI

---

Zotit Ylber Valteri

Kryetar i Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar

Me vendim te KQZ, Nr.23 date 27.04.2018 "Per shpalljen e rezultatit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar ,te cilët do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga partite politike per vitin kalendarik 2017", une Eleda Dhima, me liçence Nr. 197 date 30.01.2009 e nipt K93819401P jam caktuar Audituese Ligjore per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara ne Partine Bashkimi Demokrat Shqiptar.

Kam kenaqesine qe me anen e kesaj letre t'ju konfirmoj se e kam pranuar kete angazhim. Mbi kete baze me KQZ-ne lidha Kontraten e Sherbimit te Auditimi Nr. 579/1 date 06.06.2018. Angazhimi do te kete per objektiv te shpreh nje opinion mbi sinqeritetin, vertetesine dhe rregullshmerin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara nga subjekti juaj gjate vitit 2017. Auditimin do ta kryejme ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme e kryejme auditimin per te mare siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare per Fondet e Perfituara dhe te Shpenzuara, jane pa anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve, dokumentave dhe evidencave qe mbeshtesin shumat dhe informacionet ne Pasqyrat Financiare gjithperfshirese te hartuara per kete qellim. Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe hlogjiken e çmuarjeve kontabel te bere nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te ketyre Pasqyrave Financiare.

Ne bejten e ketyre vleresimeve te rrezikut, ne do te vleresojme kontrollin e brendshem qe ka te beje me pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktojmë ato procedura te auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit .

Ne zbatim te kerkesave te Standarteve Kontabilitetit dhe Auditimit, pergjegjesia per pergatitjen e Pasqyrave Financiare gjithperfshirese per Fondet e Perfituara dhe te Shpenzuara eshte e Drejtimit te Partise. Kjo perfshin mbajtjen e regjistrimeve te duhura kontabel dhe zbatimin e parimeve kontabel. Si pjese perberese e procesit te auditimit ne kerkojme nga drejtimi qe te marrim prej tij konfirmimin me shkrim lidhur me paraqitjet qe do te na behen ne lidhje me kete proces auditimi.

Raporti i Auditimit te Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara qe do te hartohet ne perfundim te auditimit, se bashku me Shenimet Shpjeguese qe mbeshtesin kete raport, do ti jepet KQZ-se dhe nje kopje Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar.



Shpresojme te kemi bashkepunim te plote me stafin tuaj dhe besojme se ata do te na vendosin ne dispozicion regjistrat, dokumentacionin dhe informacionin tjeter qe kerkohet per kryerjen e auditimit.

Ju lutemi te shprehni mendimin duke iu pergjigjur kesaj Letre Angazhimi per te treguar se eshte ne perputhje me kuptimin e juaj per marrveshjen e lidhur me KQZ-ne per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara gjate vitit 2017 nga Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar.  
Duke Ju Falenderuar per Bashkpunimin

**Audituese Ligjore**

**Eleda Dhima**



Tirane, me 07.06.2018

Pranuar ne emer te **Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar**

**Kryetari**

**Ylber Valteri**

Tirane me 11.06.2018



## Shpenzimet

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Totali i shpenzimeve
1	Paga			
2	Sigurime shoqerore			
3	Marrje salla me qera			
4	Reklam televizive			
5	Blerje mjete kompjuterike			
6	Sherbime telefonike			
7	Shpenzime gjyqesore		arke	57 400.00
8	Shpenzime per karburant		arke	43 400.00
9	Komisione bankare		banke	2 592.06
10	Te tjera per goma e riparim		arke	19 500.00
	<b>Totali</b>			<b>122 892.06</b>

Shumat e mesiperme si per te ardhurat e perfituara dhe te shpenzuara, per vitin 2016, konfirmohen edhe nga deklarata e leshuar nga Z. Dashamir Shehi ne cilesine e kryetarit te Partise Bashkimi Demokrat Shqiptar.

Dokumentacioni i mbajtur eshte i plote shpenzimet e kryera jane perdorur per shpenzime gjyqesore, karburant per anetaret e parties qe levizin ne rrethe per zhvillimin e aktiviteteve apo per probleme te partise. Shpenzime te tilla ne fakt jane gjithë shpenzimet e deklaruar per vitin ushtrimor 2017 ne shumen prej 122 892.06 leke.

### Gjendja e Likuiditeteve :

Gjendja e likuiditetit ne fillim te vitit sipas pasqyrave financiare dhe raporteve te llogarise bankare ishte 0 leke. Nga zhvillimi i aktivitetit ne llogarite e shoqerise jane regjistruar te ardhura 121 166.44 leke nga te cilat jane shpenzuar 122 892.06 leke. Ne mbyllje te vitit gjendja e likuiditeteve ne llogarite bankare dhe ne arke, eshte - 1 725.62 leke.

### Ngjarje te mevonshme

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Tirane, me 20.06.2018

Audituese Ligjore

Eleda Dhima

